



MBAHET NË PRISHTINË MBLEDHJA E PËRBASHKËT E QEVERISË SË KOSOVËS DHE ASAJ TË SHQIPËRISË

KOSOVA DHE SHQIPËRIA NËNSHKRUAJNË 19 MARRËVESHJE TË REJA

- Kurti dhe Rama pajtohen për të gjitha temat, jo edhe për "Ballkanin e hapur"



Me moton "Të përbashkuar", të hënën në Prishtinë është mbajtur mbledhja e përbashkët e dy qeverive shqiptare në të cilën janë nënshkruar 19 marrëveshje ndërqeveritare. Pas mbledhjes së përbashkët dhe nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe ai i Shqipërisë, Edi Rama,

kanë mbajtur një konferencë për medie, në të cilën kanë vlerësuar lart bashkëpunimin ndërmjet dy qeverive. Ata kanë thënë se marrëveshjet e nënshkruara do të kenë ndikim pozitiv për qytetarët e dy shteteve. Kurti dhe Rama janë pajtuar me pothuajse të gjitha temat, jo edhe për "Ballkanin e hapur"

AKTUALE



VENITEN SHPRESAT PËR ANËTARËSIM TË SHPEJTË TË SUEDISË DHE FINLANDËS NË NATO

F. 3

VENDET E BE-së PAJTOHEN QË LAJÇAKUT T'I ZGJATET MANDATI EDHE PËR 18 MUAJ

F. 3

EKONOMI



KARBURANTET, MË SË SHTRENJTI NË SHQIPËRI, MË SË LIRI NË MAL TË ZI

F. 8

KOMPANIA "TEHNOBURIMI" HAP FABRIKË TË RE NË SKENDERAJ

F. 8



SPORT



ERJON KASTRATI, AMBASADOR I FBK-së NË PROGRAMIN FIBA SWISH +

F. 10

VETERANËT PARALAJMËROJNË SËRISH PROTESTA PARA KUVENDIT

IFAQE 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Veniten shpresat për anëtarësim të shpejtë të Suedisë dhe Finlandës në NATO

BRUKSEL, 20 QERSHOR - Të hënën, më 20 qershor, Finlanda, Suedia dhe Turqia u ulën në tryezën e bisedimeve në Bruksel për të diskutuar mbi procesin e bllokuar të anëtarësimit për në NATO por, sipas ekspertëve, shpresat po zbehen se do të jenë në gjendje ta zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre përpara një samiti të aleancës javën e ardhshme.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, u takua me përfaqësues nga të tre vendet për të bërë përpunim në aplikimet e anëtarësimit të vendeve nordike të cilat janë bllokuar nga Ankaraja. "Unë mendoj se është e mundur, por do të ishte shumë e vështirë", tha për AFP-në, Paul Levin, drejtor i Institutit për Studimet e Turqisë në Universitetin e Stokholmit, duke shtuar se do t'u kërkonte të dyja

palëve të bëjnë kompromis. NATO dhe dy vendet nordike kishin pritur që procesi i aplikimit të ishte i shpejtë, por kundërshtimet e Ankarasë e ndalën vrullin në një kohë kur NATO dëshiron të shfaqë një front të bashkuar kundër Rusisë. Ankaraja ka akuzuar Finlandën dhe Suedinë për strehimin e anëtarëve kurdë të Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit (PKK), e renditur si një grup "terrorist" nga Turqia dhe aleatët e saj perëndimorë. Ankaraja ka kërkuar që ata ta heqin embargon e armëve ndaj Turqisë.

Çdo marrëveshje anëtarësimi në NATO duhet të miratohet unanimisht nga të 30 anëtarët e aleancës dhe tani po shtohet frika se Turqia mund ta vonojë procesin e vendeve nordike për një kohë të pacaktuar.



Von Cramon: BE-ja nuk duhet ta humbë besueshmërinë në Ballkanin Perëndimor



BRUKSEL, 20 QERSHOR - Eurodeputetja, njëkohësisht raportuesja e Kosovës për Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, u shpreh se Brukseli duhet të japë sinjale pozitive për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në prag të vendimit të kësaj jave për dhënien e statusit kandidat për Ukrainën dhe dy shtetet e tjera ish-sovjetike.

Gjatë një vizite në Sarajevë më 19 qershor, deputetja gjermane e "Të gjelbërve" u shpreh se hapja e menjëhershme e negociatave

për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut do të ndihmonin në ruajtjen e besueshmërisë në rajon.

Komentet vijnë pasi Sllovenia, një shtet anëtar i BE-së, bëri thirrje për pranimin e përsheptuar të anëtarëve aspirantë në Ballkanin Perëndimor dhe dhënien e statusit të kandidatit për Bosnjë-Hercegovinën, e cila po përballet me përpjekjet ndarëse nga udhëheqësit etnikë serbë që janë aleatë të ngushtë me Moskën.

"Ne, parlamentarët evropianë,

themi gjithnjë se në rast se Moldavia dhe Ukraina marrin statusin e kandidatit, atëherë ne duhet t'u japim diçka edhe shteteve të Ballkanit Perëndimor për t'i treguar atyre se ne jemi të besueshëm dhe se nuk ka humbur shpresa", ka deklaruar von Cramon.

E pyetur nga gazetarët mbi vendimet specifike që BE-ja duhet të marrë, ajo citoi hapjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, dhënien e statusit kandidat për Bosnjën dhe liberalizimi i vizave për Kosovën.

Zelensky parashikon shtim të sulmeve ruse këtë javë

KIEV, 20 QERSHOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka parashikuar përkeqësim të sulmeve ruse - me qëllim të marrjes së territorit të lindje të Ukrainës - teksa këtë javë mbahen takime të liderëve të Bashkimit Evropian për të vendosur nëse duhet mbështetur synimi i Kievit për t'u anëtarësuar në bllokun evropian.

Në fjalimin e tij ditë më parë, lideri ukrainas ka thënë se është e qartë "që këtë javë duhet të presim shtim të aktiviteteve armiqësore nga Rusia".

"Ne jemi duke u përgatitur. Ne jemi gati", ka thënë Zelensky për forcat e armatosura.

Ukraina ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian disa ditë pas nisjes së pushtimit rus që ka nisur më 24

shkurt.

Moldavia dhe Gjeorgjia kanë vepruar njëjtë si pasojë e kërcënimit rajonal që vjen nga sulmi i paprovokuar i Rusisë në Ukrainë.

Liderët e 27 vendeve anëtare të BE-së do t'i analizojnë aplikacionet e të tria vendeve në një samit që do të zhvillohet më 23 dhe 24 qershor dhe pritet ta përkrahin aplikimin e Ukrainës.

Javën e kaluar Komisioni Evropian ka rekomanduar statusin e kandidatit për Ukrainën dhe Moldavinë, mirëpo ka thënë se Gjeorgjia ka ende kritere që duhen plotësuar para se të bëhet vend kandidat.

Secili proces anëtarësimi merr vite derisa të finalizohet.

Në orët e para të 20 qershorit, Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë



ukrainase ka thënë se forcat ruse janë duke përdorur raketa dhe artileri për t'i bombarduar qytezat afër Severodonjeckut.

Sipas ushtrisë, forcat ukrainase dhe ato ruse janë duke luftuar

ende për ta marrë kontrollin e plotë të Severodonjeckut, qytet kyç në lindje të Ukrainës.

Presidenti rus Vladimir Putin ka pushtuar Ukrainën duke synuar që ta mbajë këtë shtet fqinj

postsovjetik larg ndikimit dhe integritetit evropian, mirëpo përpunimi në këtë aspekt ka dalë të jetë më i ngadalshëm në krahasim me atë që ka planifikuar Kremli.

Veteranët paralajmërojnë sërish protesta para Kuvendit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Organizata e Veteranëve e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka paralajmëruar të hënën sërish protesta nëse nuk ndryshohet Projektligji për Pagën Minimale i cili tashmë është miratuar në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës. Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL të UÇK-së), Faton Klinaku, ka thënë në një konferencë për medie se nëse nuk përfshihet rritja e pensionit të veteranëve në këtë projektligj, atëherë veteranët do të mbajnë protestë para Kuvendit në ditën kur do të shqyrtohet kjo çështje në lexim të dytë. Sipas tij, në takimin që është zhvilluar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, më 17 qershor, nuk është arritur pajtueshmëri. "Kurti vazhdon të insistojë në qëndrimet e tij diskriminuese,

me tendenca politizuese ndaj çështjes së veteranëve dhe nuk plotësoi kërkesën tonë që është minimale, jodiskriminim të veteranëve në ligjin për pagën minimale", ka thënë ai.

Klinaku ka theksuar se janë në pritje të propozimeve të reja nga Qeveria dhe Kuvendi.

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abeldar Tahiri, ka thënë të hënën se më vonë gjatë ditës do të procedojnë për votim disa amendamente që do të mundësojnë që pensioni i veteranëve të jetë në nivelin e pagës minimale.

Amendamentet votohen kur të miratohet një projektligj në lexim të dytë. "Kjo është periudhë kohore mbi të cilën edhe duhet të dialogohet me qeverinë dhe ne si deputetë duhet ta bëjmë punën tonë", ka thënë Tahiri.

Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka rikujtuar që kjo parti veçse ka



dërguar dy amendamente për shqyrtim. Njëra kërkon që deri në kategorizim të veteranëve pensioni i tyre të jetë i barasvlershëm me pagën

minimale, ndërsa i dyti që paga minimale të jetë 370 euro neto. Projektligji i miratuar parasheh rritjen e pagës minimale në 264 euro bruto, apo 250 euro neto,

nga 130-170 sa është aktualisht. Në rast se miratohet edhe në leximin e dytë ashtu siç është, veteranët do të vazhdojnë të marrin pension në vlerë 170 euro.

Festivali "Sunny Hill" rikthehet në Kosovë



Prishtinë, 20 qershor (ER) - Festivali "Sunny Hill" do të mbahet në Prishtinë më 4, 5, 6 dhe 7 gusht të këtij viti. Kështu është thënë në një deklaratë të përbashkët të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë, komunës së Prishtinës dhe Festivalit "Sunny Hill". Sipas tyre, institucionet qendrore dhe ato lokale do të ofrojnë mbështetje për edicionin e sivjetmë, i cili është thënë se do të mbahet në një lokacion të përshtatshëm. "Institucionet qendrore dhe lokale bashkërisht, sipas mandatit që kanë, do të ofrojnë mbështetje

të plotë për edicionin e sivjetmë, i cili do të mbahet në një lokacion të përshtatshëm. Të gjithë shprehin gatishmërinë që çështja e shfrytëzimit afatgjatë të tokës të diskutohet edhe pak kohë deri në gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme. Synimi i përbashkët është që nga viti i ardhshëm festivali "Sunny Hill" të organizohet në lokacionin e vet afatgjatë. Në frymën e bashkëpunimit të shkëlqyeshëm kulturor mes Kosovës dhe Shqipërisë, një edicion i veçantë me një line-up tjetër do të mbahet në fund të muajit gusht në Tiranë më 26, 27

dhe 28 gusht", është thënë në deklaratën për medie.

Në Prishtinë, "Sunny Hill Festival" për këtë vit ka përgatitur lineup-in më të fuqishëm nga festivalet e rajonit ku, përveç artistëve të njohur si Diplo, Skepta, DJ Regard, AJ Tracey, Mahmood dhe artistët më të njohur shqiptarë, për këtë edicion pritet të zbulohen edhe dy artistë shumë të mëdhenj botërorë. "Një verë e jashtëzakonshme i pret të gjithë shqiptarët në Prishtinë dhe në Tiranë", thuhet në deklaratë. Edicionet e kaluara janë mbajtur në Parkun e Gërmisë në Prishtinë.

Vendet e BE-së pajtohen që Lajçakut t'i zgjatet mandati edhe për 18 muaj

BRUKSEL, 20 QERSHOR - Vendet e Bashkimit Evropian do të pranojnë që të dërguarit të posaçëm të BE-së për dialog ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, t'i zgjatet mandati edhe për 18 muaj.

"Radio Evropa e Lirë" mëson nga burimet diplomatike në Bruksel se në takimet e përfaqësuesve të vendeve anëtare asnjë shtet nuk e ka kundërshtuar vazhdimin e mandatit të Lajçakut.

Tash mbetet të kryhet vetëm pjesa formale. Kështu, ish-ministrin të Jashtëm të Sllovakisë, Miroslav Lajçak, pritet t'i vazhdohet mandati deri më 1 prill të vitit 2024.

Ai kishte nisur mandatin fillimisht njëvjeçar në prill të vitit 2020, pastaj i ishte vazhduar mandati edhe pas 1 prillit 2021 për 18 muaj.

Vazhdimi i ri prej 18 muajve shtesë, i cili pritet të konfirmohet edhe formalisht këto ditë në Bruksel, do të bëjë që Lajçaku të jetë në këtë pozitë gjithsej katër vjet.

Ndonëse nga disa shtete të BE-së është shprehur pakënaqësi për shkak se në vitet e fundit nuk ka pasur përparim konkret në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, asnjë shtet nuk e ka kundërshtuar vazhdimin e mandatit të Miroslav Lajçakut dhe ekipit të tij.





Mbahet në Prishtinë mbledhja e përbashkët e Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë

Kosova dhe Shqipëria nënshkruajnë 19 marrëveshje të reja

- Kurti dhe Rama pajtohen për të gjitha temat, jo edhe për “Ballkanin e hapur”

Me moton “Të përbashkuar” të hënën në Prishtinë është mbajtur mbledhja e përbashkët e dy qeverive shqiptare në të cilën janë nënshkruar 19 marrëveshje ndërqeveritare. Pas mbledhjes së përbashkët dhe nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe ai i Shqipërisë, Edi Rama, kanë mbajtur një konferencë për medie, në të cilën kanë vlerësuar lart bashkëpunimin ndërmjet dy qeverive. Ata kanë thënë se marrëveshjet e nënshkruara do të kenë ndikim pozitiv për qytetarët e dy shteteve. Kurti dhe Rama janë pajtuar me pothuajse të gjitha temat me përjashtim të “Ballkanit të hapur”

EPOKA E RE

Lirim GEÇI

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Kosova dhe Shqipëria të hënën kanë mbajtur mbledhjen e përbashkët të dy qeverive. Në këtë mbledhje, e teta me radhë, janë nënshkruar 19 marrëveshje ndërqeveritare. Këto marrëveshje përfshijnë sektorë të ndryshëm në kuadër të mbledhjeve të përbashkëta tradicionale që janë duke u mbajtur në mes të dy shteteve.

Nga Qeveria e Kosovës kanë thënë se marrëveshjet dhe memorandumet ndërqeveritare janë arritur në fushën e arsimit, doganave, energjisë, bujqësisë, infrastrukturës rrugore, transportit, shëndetësisë, mbrojtjes dhe drejtësisë.

Në sektorin e arsimit është arritur marrëveshje për mundësi konkurrimi dhe vazhdim të studimeve në 19 universitete të të dyja shteteve në kushte të barabarta.

Në këtë mbledhje të qeverive palët janë pajtuar për të punuar për lehtësimin e plotë të lëvizjes së lirë mes dy shteteve, më pas për të krijuar një platformë të përbashkët digjitale për promovim të turizmit të të dyja vendeve.

Në sektorin e transportit është arritur marrëveshje për një studim fizibiliteti që i hap rrugë ndërtimit të linjës hekurudhore Durrës - Prishtinë, projekt që synon ta lehtësojë transportin e njerëzve dhe mallrave.

Kurti: Vendet tona s'i bën bashkë interesi, por është në interesin tonë të qëndrojmë bashkë

Pas mbledhjes së dy qeverive dhe nënshkrimit të marrëveshjeve, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe ai i Shqipërisë, Edi Rama, kanë mbajtur një konferencë për medie. Në këtë konferencë ata kanë folur për marrëveshjet e arritura, bashkëpunimet e deritanishme dhe për temat me të cilat nuk kanë pajtueshmëri, siç është tema e “Ballkanit të hapur”.

Por, fillimisht, kryeministri Kurti ka bërë thirrje për besim të ndërsjellë social. “Vendet tona nuk i bën bashkë interesi, por është në interesin tonë që të qëndrojmë bashkë. Aq sa na bashkon historia, gjuha dhe kombi, aq duhet të na

lidhë bashkëpunimi institucional në çdo fushë”, ka thënë Kurti.

Më tutje, Kurti ka bërë me dije se në kuadër të mbledhjeve të përbashkëta të qeverive, në të kaluarën janë nënshkruar 127 marrëveshje, kurse janë zbatuar 75 prej tyre. Megjithatë, Kurti ka përmendur se ekziston nevoja e një harmonizimi e bashkërendimi më të mirë “të politikave dhe veprimeve mes dy vendeve tona si në çështje rajonale, po ashtu edhe të politikës së jashtme”. “Gëzohem që nënshkruam 19 marrëveshje të tjera, në fushën e arsimit, shëndetësisë, sigurisë e fusha të tjera. Marrëveshjet bilaterale në mes të dy vendeve bëhen për t'i shtuar marrëdhëniet dhe për t'i ofruar qytetarët, të përbashkuar si sot rreth nevojës e dëshirës për zhvillim, barazi e mirëqenie”, ka thënë Kurti.

I pyetur për nismën “Ballkanin e hapur”, në të cilën merr pjesë



Shqipëria, por jo edhe Kosova, dhe për ndikimin e këtyre qëndrimeve në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve, Kurti ka thënë se këto shtete kanë raporte vëllazërore dhe se iniciativa del përtej lidhjeve bilaterale. "Marrëdhëniet tona bilaterale janë të shkëlqyeshme dhe vëllazërore. Vëllazërit nuk kanë ndërmjetësues mes njëri-tjetrit. Prandaj mbledhja e këtillë është takim që t'i forcojmë të dyja shtetet tona në funksion të qytetarëve tanë për nevojat dhe dëshirat e tyre", është shprehur Kurti.

Rama: Me qeverinë aktuale kemi shkallën më të lartë të zbatimit të marrëveshjeve

Ndërsa kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë një bilanc të mbledhjes së përbashkët të dy qeverive. Ai ka thënë se mbledhja e së hënës ka qenë mjaft produktive sa i takon bashkëpunimit të dy shteteve. "Nuk e ekzagjeroj fare po të them se pas çdo mbledhjeje të përbashkët ne i afrohem pak më shumë qëllimit të madh të dokumentit të partneritetit strategjik në mes të dy shteteve tona, të nënshkruar në Prizren më 2014", ka thënë Rama, duke shtuar se volumi tregtar para bashkëpunimit të afërt në mes të dy vendeve ka qenë 136 milionë, ndërsa tani ka arritur në 433 milionë.

Rama është deklaruar edhe rreth atyre që i ka konsideruar komente

Në nëntor mbahet mbledhja e përbashkët e dy kuvendeve shqiptare

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, gjatë konferencës për medie me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se në mbledhjen e dy qeverive janë pajtuar për mbajtjen e një Kuvendi të përbashkët në nëntor në kuadër të 110-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. "Kemi rënë dakord, që në kuadër të 110-vjetorit të flamurit tonë kombëtar, të pavarësisë së Shqipërisë, ta organizojmë për herë të parë Kuvendin e përbashkët të dy republikave. Një seancë jubilarë, ku deputetët e të dyja shteteve

do të jenë bashkë, për të adresuar, popullin shqiptar, kudo ku ai ndodhet dhe, po ashtu, kemi rënë dakord që në periudhën e fundit të vitit ta publikojmë edhe revistën e parë bashkëqeveritare që do t'u shërbejë të gjithëve për t'i parë të gjitha faktet dhe shifrat e bashkëpunimit, të gjitha marrëveshjet dhe nivelin e zbatimit të tyre. Në këtë mënyrë do të kemi një fletore zyrtare të të dyja qeverive që do të publikohet rregullisht në fund të çdo viti, për t'i informuar të gjithë të interesuarit", ka thënë Rama.

mbi mosmarrëveshje dhe mungesë të ecurisë së punës në mes të dy qeverive. "Me qeverinë aktuale ne kemi shkallën më të lartë të zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara, përfshirë edhe marrëveshjet e nënshkruara në të kaluarën", është shprehur Rama. Kurse sa i përket "Ballkanit të hapur", Rama ka thënë se është e vërtetë që nuk bashkon dy vendet, por "është kaq e vërtetë që nuk na ndan". "Në këtë pikë kemi këndvështrime të ndryshme. Ky nuk është sekret, por këto këndvështrime të ndryshme në këtë pikë nuk na pengojnë që në marrëdhëniet bilaterale të vazhdojmë të ecim përpara", ka deklaruar Rama.

Në këtë konferencë, Rama ka folur edhe raportimet në medie se ai është i interesuar që ta rrezojë Albin Kurtin nga pushteti. Në këtë kontekst, Rama ka thënë se nuk është i interesuar të përfshihet në jetën politike të Kosovës. "Kam dhe një lajm për ata që kërkojnë të gjejnë arsye që të bëjnë komente mbi mosmarrëveshje dhe mungesë të ecurisë së duhur të punës së duhur, me qeverinë aktuale. Ne kemi shkallën më të lartë të zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara në krahasim me marrëveshjet e kaluara. Shpresoj që ky të konsiderohet një fakt dhe jo të bëhen spekulime të tjera. Jam i painteresuar të përfshihem në jetën politike të Kosovës", ka thënë Rama.

Marrëveshjet e nënshkruara në mes të dy qeverive

- Marrëveshja për bashkëfinancimin ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Republikës së Kosovës për studimin e fizibilitetit dhe projekt - idesë për lidhjen hekurudhore Durrës - Prishtinë.
- Marrëveshja administrative për zbatimin e marrëveshjes për sigurime shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.
- Protokollin ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kosovës për implementimin e kontrollit të përbashkët kufitar dhe pagesën e shpenzimeve gjatë punëve të kryera në pikën e përbashkët të kalimit kufitar M o r i n ë / K u k ë s (Vërmicë/Prizren).
- Marrëveshja e bashkëpunimit në fushën e zbatimit të programeve të mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës.
- Marrëveshja e bashkëpunimit për shkëmbim përvojash në proceset teknike ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës.
- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për pranimin e studentëve në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.
- Marrëveshja për bashkëpunimin në fushën farmaceutike dhe të pajisjeve mjekësore ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës.
- Marrëveshja për bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë për shërbimin e ndërsjellë ndërkufitar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës.
- Protokollin ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës për regjimin e trafikut lokal të kufirit në zonat kufitare ndërmjet kufirit shtetëror të Republikës së

- Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.
- Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës për bashkëpunim në fushën e gjendjes civile.
- Deklarata e përbashkët e Ministrave të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.
- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë së Republikës së Kosovës për krijimin e një platforme të përbashkët digjitale të informacionit dhe promovimit turistik.
- Memorandumi i mirëkuptimit për sektorin e energjisë ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Ekonomisë së Republikës së Kosovës.
- Marrëveshja bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Republikës së Kosovës për vlerësimin e gjendjes dhe përmirësimin e rrugëve të fshatrave ndërkufitare që lidhin zonat kufitare Shqipëri-Kosovë.
- Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës për bashkëpunim në fushën e rinisë.
- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëfinancimin e projektit madhor në albanologji enciklopedia shqiptare.
- Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Ekonomisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim mbi zhvillimin e terminalit Lungomare të Vlorës.
- Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e kërkim shpëtimit malor dhe ujëra territoriale.
- Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës për ngritjen e një grupi të përbashkët pune për bashkim doganor.



Mrizi i politikanëve në mallkimin e zanave!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Armiqësi e trashëguar apo e planifikuar: Marrëdhëniet midis Edi Ramës, kryeministër i Shqipërisë dhe të Albin Kurtit, kryeministër i Kosovës, janë në pikën më të ulët të mundshëm duke prekur fundin e moçalit politik. Edi Rama po i afrohet 20-vjetorit të majave të pushtetit në Shqipëri duke pasur rezultate të dukshme dhe të prekshme si në ndryshimin e fytyrës së Tiranës, ashtu edhe në ndryshimin e pamjes dhe të përmbajtjes së Shqipërisë, sidomos në zhvillimin e turizmit dhe ndërtimit të infrastrukturës rrugore. Gjithashtu ka arritur ta ruajë një paqe sociale në kohët kur bota po përjeton një krizë të thella ekonomike. Në planin e afirmimit ndërkombëtar ka arritur ta nxjerrë Shqipërinë nga mentaliteti i Kanunit të Lekë Dukagjinit duke e mbushur me një përmbajtje të një shteti që po e merr reputacionin e një shteti modern nga një Lidhje Fisesh politike dhe jo vetëm politike që ishte deri vonë. Është e fshehtë publike se parat e pista (nga tregtimi

me narkotikë, trafikimi me qenie njerëzore, prostitucioni dhe korrupsioni i nivelit të lartë) kanë ndikuar shumë në zhvillimin e Shqipërisë sidomos pas shembjes së diktaturës komuniste. Po duket se kjo dukuri është marrë si model nga shtetet që tashmë kanë ecur shumë më larg se Shqipëria në zhvillim sikur që ishin Italia, ShBA, Brazili, Argjentina, Dubai, Kina, Mbretëria e Britanisë së Madhe dhe shumë shtete tjera ku mafia kishte rol përcaktues për zhvillim e pastaj u zëvendësua me një shtet ligjor duke mos e përjashtuar ende ndikimin e mafies, tashmë si politikanë. Nëse e bëni një krahasim të Shqipërisë të viteve të '90-ta me Shqipërinë e sotme, dallimi është i pakrahasueshëm. Madje, asnjë shtet i rajonit nuk është zhvilluar si Shqipëria në këtë periudhë kohore. Shqipëria ka përfituar shumë edhe nga emigracioni i hershëm në SHBA dhe ai pas shembjes së komunizmit e që ishte më i theksuar në Itali dhe Greqi. Për dallim nga emigracioni

kosovar, ata të Shqipërisë kapitalin e fituar, pavarësisht pastërtisë, e investuan në Shqipëri kurse këta të Kosovës e që e kishin kapitalin e fituar kryesisht me djersë dhe shumë mundime e investuan duke ndihmuar familjet dhe duke ndërtuar shtëpi. Kurse kapitali i fituar në mënyrë të kundërligjshme në Kosovë u bartë në vende tjera apo u fsheh duke u shndërruar në kapital të vdekur. Edi Rama në Shqipëri u bë person karizmatik pasi e "vrau" babanë politik Fatos Nanon pas së cilës, pos liderit të PS-së u bë edhe personalitet i pakontestueshëm dhe pakonkurrencë i politikës shqiptare. Aktualisht në Shqipëri nuk ka konkurrencë, as në PS e as në nivel kombëtar për faktin se Lulëzim Basha ishte fort i qullët në bërje të opozitës kurse aktualisht Sali Berisha më shumë e forcon Ramën se si alternativë e vetme e që e rrezikon. Sali Berishën e nxorën nga loja amerikanët duke e shpallur "non grata", kurse Ilir Metës i rri mbi qafë "Shpata e Demokleut" e personifikuar si SPAK dhe, pa asnjë dyshim duket se as

amerikanët nuk e kanë ndonjë simpati të madhe për të për shkak të përpjekjeve për të penguar reformat në drejtësi. Duket se aktualisht Ilir Meta nuk ka të ardhme politike por vetëm të kaluar politike në kohën kur e tashmja përfundon shumë shpejt. Në mungesë të konkurrencës politike në Shqipëri dhe ringjalljes së shpresave në trojet tjera ku jetojnë shqiptarët se Edi Rama është edhe kryeministër i tyre, edhe në Kosovë krediti politik dhe kombëtar i Edi Ramës ishte në nivelet më të larta deri në çastin kur Albin Kurti fitoi 51% të votave në Kosovës që i dhanë fuqinë e Zeusit të cilin, deri në këtë kohë e kishte Edi Rama. Tirana ishte Orakulli ku Zeusi (Edi Rama) pyetej për çdo gjë kurse Prishtina ishte një Bujtinë ku shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe të Malit të Zi, kryesisht të hasmuar mes veti kërkonin këshilla nga udhëheqësit kosovarë, jo për t'i zgjidhur problemet politike por për ta luftuar dhe eliminuar kundërshtarit politik i cili ishte shqiptar. Më parë kishte përpjekje edhe në

Maqedoninë e Veriut përmes "Pykës së Albinit", Zijadin Selës i cili nuk arriti asnjëherë ta sfidojë autoritetin e Udhëheqësit të Madh të Popullit Shqiptar (cilësim dhe glorifikim i Ismet Sylejmanit) Ali Ahmetit dhe tashmë Sela, nga një zëdhënës i Albinit për ndryshime në këtë shtet u shndërrua në një tullumbace të shfryrë që fluturon nga e bartë era. Është një fakt që nuk mund të mohohet se askush si Albin Kurti nuk e ka fituar pushtetin më me shumë mund, punë dhe vuajtje. Makiaveli është zero për Albin Kurtin, një amator përshtues siç ishte fillimisht edhe Albin Kurti por që, në kohën e duhur kur i duheshin 51% të votave veçoi me një saktësi të jashtëzakonshme duke i bërë llogaritë pikërisht si duhet dhe ashtu edhe i doli. Kjo fitore e Albinit e vuri përballë Edi Ramës ndaj të cilit një numër i lexueshëm i kosovarëve kishte kompleks inferioriteti të theksuar dhe të cilin donin ta shëronin duke e përdorur Albin Kurtin si terapi. Edhe Albinit kjo situatë i pëlqente sepse

mendonte se Bujtinën e Prishtinës do ta shndërronte në Orakull dhe se ai do të shndërrohej në Zot i të gjithë zotave - Zeusi vet. I doli shumë gabim. Ideologët e Tiranës e këshilluan që ta shtrijë autoritetin dhe pushtetin edhe në Shqipëri përmes pjesëmarrjes në zgjedhje ku edhe pësoi fijasko të paparë dhe të papritur aq më parë që sondazhet, mbase të porositura, e bënë pjesë të Kuvendit të Shqipërisë. Kjo humbje dhe ky turpërim vetëm sa e forcoi egon e Kurtit se para Ramës nuk duhet të dorëzohet me asnjë kusht dhe me asnjë çmim. Ky qëndrim ishte paracaktuar të dështonte aq më parë që Rama e luajti lojën e demokratit dhe të durueshmit duke mos e sulmuar fare Kurtin. Ballkani i Hapur është vetëm preteksti i vazhdimit të luftës së Albin Kurtit kundër Edi Ramës kurse konteksti është egoja e cenuar e Albin Kurtit përballë Edi Ramës. Pra, nuk mund të flitet për parime politike, njerëzore, morale e aq më pak për ato kombëtare por thjesht po luftohet kush do të jetë zotëruar i Orakullit qoftë edhe për një mandat të vetëm. Albin Kurti i ka pasur të gjitha mundësitë të shndërrohet në një lider kombëtar dhe politik po të mos i shkelte të gjitha parimet e proklamuar nga vet ai, si parime të panegociueshme. Ndonëse është kryeministër me më së shumti vota në Kosovë, me një shpejtësi të pabesueshme po shndërrohet vetëm në një lider të një pjese të Vetëvendosjes, as i krejt Vetëvendosjes. Me një fjalë, Edi Rama përveç se është kryeministër i Shqipërisë në të njëjtën kohë ka edhe një post më të rëndësishëm; është burrështetas i Shqipërisë sepse merr vendime edhe në rast se nuk pajtohet me to por që llogaritë se i bëjnë mirë Shqipërisë. Për ta thjeshtësuar analizën e them se Edi Rama është kryeministër dhe lider strategjik kurse Albin Kurti, kryesisht me fajin e vet po shndërrohet në kryeministër të çastit që mbijeton në sajë të lëvizjeve taktike e sidomos shkaku se opozita e Kosovës nuk ka asnjë interesim ta rrëzojë nga pushteti e as ta marrë pushtetin edhe në rast se Albini do të bie nga fiku!

A do të rrëzohet Albini në muajin shtator: Nga doli një informatë se në takimin e Ohrit për Ballkanin e Hapur, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama paska thënë se deri në muajin shtator do ta rrëzojë Albin Kurtin dhe në Kosovë u aktivizua refleksi automatik i konspiracionit për rrëzim të Kurtit dhe të atyre që nuk iu ha palla aspak nëse do të rrëzohet Kurti por se janë të brengosur për postet që pameritueshëm i mbajnë, kryesisht përmes servilizmit dhe të cilët kanë mungesë të theksuar të dijës dhe profesionalizmit e që i bëjnë lëvyrës dhe njerëz pa vlera. Natyrisht se këta janë vënë në mbrojtje të Albin Kurtit. Vizita e Edi Ramës familjes së Hashim Thaçit në Burojë e që po mbahet si rob i pasluftës me të arrestuarit tjerë në Hagë dhe fjalët e mëdha që i përdori për Hashim Thaçin, e hidhëruan shumë kryeministrin Kurti aq më parë që edhe në kohën kur Hashim Thaçin e kanë lidhur këmbë e duar, Albini e konsideron Thaçin si armik personal. Pastaj, takimi i Edi Ramës me një grup afaristësh kosovarë e që e organizoi Kompania Devolli që i ka shpërthyer kufijtë e Kosovës me suksesin në biznes, ishte edhe një mëlmesë e hidhur për Albinin dhe një bakllava për Edi Ramën. Si një qershizë mbi torte për ta dëshmuar konspiracionin ishte darka e Edi Ramës me përfaqësues të mediave që konsiderohen si kundërshtarë të kryeministrin Kurti. Në vend se të konsiderohet si Darka e Lamës e që do të kalohej në hajgare, po e cilësojnë si Darka e Fundit ku u vendos të tradhëtohej dhe kryqëzohej Krishti (Albin Kurti). Të mos pajtohesh me politikën e një kryeministri nuk nënkupton domosdoshmërisht edhe organizim për rrëzim të tij. Më kujtohet, po besoj edhe juve lexues të nderuar se pjesa më e madhe e opinionistëve që morën pjesë në Darkën e Fundit (Darkën e Krishtit) dikur ishin kundërshtarë të mëdhenj të Edi Ramës dhe përkrahës të fuqishëm të Albin Kurtit. Madje, vullnetarisht e përkrahnin Albin Kurtin para zgjedhjeve të fundit me shpresë se një qeverisje e vjetër që personifikohej me klasën e kaluar politike dhe që cilësohej si e keqe do të

zëvendësohet me një qeverisje të re të një klase të re të idealistëve politikë që udhëhiqeshin nga Albin Kurti e që besoj se do t'i kthente shpresat për një jetë më të mirë. Deri më tani, shkaku i rrethanave objektive dhe subjektive nuk ka asnjë ndryshim për kthim të shpresës për një jetë më të mirë. Ju kujtohet që një opinioniste e jashtëzakonshme, shumë e kthjellët dhe e guximshme, Kimete Berisha para zgjedhjeve të fundit, ka përdorur të gjitha armët që i ka pasur në dispozicion në përkrahje të Albin Kurtit dhe Vetëvendosjes, përveç armatimit bërthamor kurse, pas zgjedhjeve të fundit, kur ka filluar ta shfaq një qëndrim mospajtuës me Vetëvendosjen dhe kryeministrin Kurti i është nënshtruar një linçimi të paparë dhe të paskrupullt nga "vrasësit" dhe qitësit e LV-së, kujdestarë 24 orë të rrjeteve sociale. Kurrë nuk keni parë ndonjë reagim ndaj këtij linçimi. Albin Kurti është dashur ta bëjë një dallim dhe prerje midis liderit të opozitës dhe kryeministrin të mandatuar. Nëse ka fituar vota duke e sulmuar qeverisjen 20-vjeçare dhe duke i cilësuar publikisht udhëheqësit e UÇK-së, tash ish-udhëheqës institucionalë si kriminelë, duke shfaqur ngazëllim për arrestimin e tyre dhe duke e arsyetuar edhe tash se dështimet e qeverisjes së tij janë pasojë e asaj qeverisjeje e jo se e ka një kabinet qeveritar të padijshëm, me mungesë të theksuar të profesionalizmit të cilët vendin e parë të punës e kanë si bartës servilë të këtyre posteve, më askujt nuk ia ndiejë arsyetimi meskin që, si kor i papagajve e përdorin ministra e zv/ministra, që korrupsionin, nepotizmin dhe kapjen e institucioneve e kanë shndërruar në art! Nuk i takon kryeministrin Kurti që të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë e pengjeve të Hagës por se tash, si kryeministër i të gjithë qytetarëve të Kosovës i takon ta luaj rolin që ia siguron mandati, të mos bëjë dallime dhe të mos shfaqë urrejtje ndaj qytetarëve të Kosovës që janë në Hagë për shkak të armiqësisë personale që e ka pasur apo që e ka ende. Nëse kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka vizituar të burgosurit e

Hagës (jo të gjithë) pse këtë nuk e ka bërë edhe kryeministri Kurti por ka dërguar bedelë të paguar që t'i vizitojnë ndonëse nuk kanë dashur t'ua shohin as sytë. Kur bedelët e mëparshëm i dështuan, kryeministri Kurti deklaroi se do të vizitojë (në një të ardhme të papërcaktuar) dhe në ndërkohë shkoi një udhëheqës i lartë i partisë së tij, i shoqëruar nga një patriot i përmasave mbarëkombëtare por se Kurti e la, për më vonë! Këto nuk mund të cilësohen ndryshe përveç se përpjekje të ndyra që në kurriz të fatkeqësive të të tjerëve, qoftë të viktimave, qoftë të atyre që akuzohen se i kanë shkaktuar këto viktima, të përfitohet politikisht! Asgjë tjetër! Nëse dikush nga LV-ja mund të brengoset se Kurti mund të rrëzohet nga pushteti e që nënkupton se do të shndërrohen në vdekatarë të rëndomtë, pa mundësi të hakmerren ndaj kundërshtarëve politikë që i konsiderojnë armiq, pa mundësi që t'i punësojnë edhe familjarët, miqtë dhe jaranat e mbetur përkohësisht pa punë, pa mundësi të realizojnë edhe shumë marifete të tjera, me një siguri të madhe iu garantoj se askush nuk ka interesim ta rrëzojë Albin Kurtin nga pushteti edhe nëse në rast se iu krijohen kushtet. I vetmi njeri që mund ta rrëzojë Albin Kurtin nga pushteti është vet Albin Kurti, nëse e vlerëson se përmes këtij rrëzimi do të fuqizohet politikisht. Albin Kurti, edhe nëse rrëzohet ka dëshirë të rrëzohet si viktimë për t'u rikthyer duke kaluar në procesin e viktimizimit. Askush më nuk do ia jepë atë mundësi sepse askush nuk është më politikisht i marrë. Herën e fundit, për rrëzim ishte fajtor Riçard Grenell dhe Donalld Tramp, përmes instrumenteve politike të vendit. Tash, për ta rrëzuar nuk kanë interesim as Blinken e as Biden aq më parë që në arenën ndërkombëtare Albin po paraqitet si kryeministër i Ukrainës kurse Vojsa Osmani si presidente e Ukrainës. Prandaj nuk po kanë kohë të merren me problemet reale të qytetarëve të Kosovës të cilëve, për shkak të situatës së përgjithshme objektive nuk ka mundësi t'ua zgjidhë ato probleme por ka

mundësi dhe detyrim t'ua lehtësojë ato. Aq më pak është i interesuar ta rrëzojë Albin Kurtin, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama i cili e ka lexuar Kurtin aq mirë sa që është i interesuar që Kurti të qëndrojë sa më gjatë në pushtet sepse më nuk ka të panjohura sa i përket Kurtit kurse me një lojtar tjetër do të luhej një lojë tjetër që, më shumë do ta relativizonte lidershipin e Babait të Kombit të Edi Ramës se që do ta vinte në pikëpyetje! Për mua është befasuese, e çuditshme por edhe e papranueshme që historia të shkruhet dhe rishkruhet nga çdo klasë politike që i fiton zgjedhjet, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Shqipëria dhe Kosova, nëse nuk bashkohen e që të gjitha kushtet janë për bashkim, do të ngelin provinca të Ballkanit, Evropës dhe të Botës, pa ndonjë ndikim në procese politike dhe zhvillimore. Mbetet të shihet nëse kryeministri i Ukrainës, Albin Kurti dhe presidentja e Ukrainës, Vjosa Osmani do të mbrojnë integritetin e Ukrainës, me Donbasin dhe Lluhanskin Brenda. Në të kundërtën nuk ka asnjë pengesë që kryeministri i Kosovës, Zielinski të shpallë bashkimin apo rikthimin e territorit të Kosovës në Shqipëri e që padrejtësisht ishte pushtuar nga Serbia (Rusia). Prandaj, nuk ka opozitë në Kosovë, qoftë ajo politike, parapolitike apo mediatike që është e interesuar dhe që mund ta rrëzojë Albin Kurtin. Albin Kurtin mund ta rrëzojnë proceset politike dhe vendimet që duhet të merren sikur edhe injorantët parazitë që janë pajisur me poste të pamerituara. Po mos të ishin të tillët nuk do të detyroheshin ta bëjnë punën m.. dhe pastaj të detyrohen ta hanë pikërisht atë që e kanë bërë sikur me rastin e Gazsjellësit amerikan dhe të Sunny Hill. Fillimisht i refuzuan, tani, të penduar dhe pas analizave të "thella" dhe plotësimit të dokumentacionit po i pranojnë! Krejt në fund, po t'i konvenonin LV-së zgjedhjet e parakohshme, ata vet do ta rrëzonin qeverinë duke shfrytëzuar dy mundësi të arta ku deputetët e tyre mund të marrin në thua: votimin e Kodit Civil për martesë të gjinisë së njëjtë dhe tërheqja e mjeteve nga Trusti!

Kompania "TehnoBurimi" hap fabrikë të re në Skenderaj

SKENDERAJ, 20 QERSHOR (ER) - Shumë objekte industriale të ndërtuara nga betoni i parafabrikuar në Kosovë, siç janë fabrika e "Princit" në Pejë, fabrika "M&Silloi" në Xërxë, objekti madhështor i kompanisë "Comodita" në Gjakovë e shumë ndërtime të tjera në Kosovë dhe jo vetëm, mbajnë vulën e kompanisë "TehnoBurimi".

"7 Ditë me Panxhën" i ka

kushtuar një storie hedhjes së gurëthemelit për fabrikën më të re të industrisë së drurit dhe betonit të parafabrikuar në komunën e Skenderajt.

Komuna e Skenderajt, pasi kishte shpallur njoftimin për dhënie në shfrytëzim të disa pronave, kishte zgjuar interesimin e kompanisë "TehnoBurimi". Komuna kishte mirëpritur një projekt

të tillë duke rezultuar në një marrëveshje të nënshkruar.

Kryetari i Skenderajt, Fadil Nura, ka thënë se të gjithë investitorët të cilët kanë interesim për ngritjen e kapitalit të tyre në Skenderaj dhe kanë për qëllim që të punësojnë të paktën pesë punëtorë, komuna do t'u ofrojë lehtësime si lirim nga taksa e lejes së ndërtimit dhe lirim nga taksa për biznes.



KRU 'Prishtina': Uji në liqenet e Batllavës dhe Badocit është nën nivelin maksimal



PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar për gjendjen me ujë në liqenet e Batllavës dhe

Badocit. Sipas KRU-së, gjendja është nën nivelin maksimal të kapërderdhjes. "Niveli i ujit në liqenin e Batllavës sot është 1.19 metra nën nivelin

maksimal të kapërderdhjes, ndërsa Badoci 7.65 metra", thuhet në njoftimin e KRU-së. Po ashtu, kompania thotë se gjatë inspektimeve të terrenit

janë zënë dhjetëra kyçje ilegale. "Javën e fundit, përgjatë inspektimit në terren, janë zënë dhjetëra kyçje ilegale. Keni parasysh, kyçjet

ilegale dhe mospagesa e faturave të ujit janë faktorët kyçë në rrezikimin e furnizimit me ujë të pijshëm", njofton kompania.

Karburantet, më së shtrenjti në Shqipëri, më së liri në Mal të Zi



PRISHTINË, 20 QERSHOR - Çmimet e karburanteve në Evropë janë vazhdimisht në rritje kryesisht për shkak të pushtimit rus të Ukrainës. Në Ballkanin Perëndimor karburantet kushtojnë më së shtrenjti në Shqipëri. Çmimi i një litri naftë atje, më 20 qershor 2022, ka qenë më i

lartë se në Gjermani, në vendin me ekonominë më të zhvilluar në BE.

Çmimet e Eurosuper 95 dhe Eurodiesel në Mal të Zi janë më të ulëtat ndër vendet e rajonit, sipas të dhënave të Buletinit të Ministrisë së Investimeve Kapitale në Mal të Zi, shkruan "TV Teuta". Sipas

këtyre të dhënave për çmimet e derivateve të naftës, një litër Eurosuper 95 në Mal të Zi kushton 1.55 euro.

Në Shqipëri çmimi është 2,03 euro, Kosovë 1.90 euro, Kroaci 1,83 euro, Maqedoni e Veriut 1,82 euro, Serbi 1,69 euro dhe Bosnjë dhe Hercegovinë (BiH) 1,66 euro.

Të mërkurën seanca për Trustin

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka thënë se të mërkurën mbahet seanca për

ndryshimin e Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës përmes të cilit mundësohet tërheqja e 30 për qind të mjeteve nga Trusti. "Në seancën e së

mërkurës do të jetë në rend dite Projektligji për tërheqjen e kursimeve nga Fondi i Kursimeve Pensionale. Një kërkesë e qytetarëve që po vjen në kohën kur vendi po

ballafaqohet me një rritje të çmimeve të produkteve esenciale ushqimore e të derivateve dhe të sfidës së energjisë elektrike", ka thënë Tahiri.



Kontinentet e humbura mund të fshihen në brendësi të Tokës



Në kreshtat e mesit të oqeanit, magma flluskuese del përmes të çarave në fundin e detit për të formuar koren e re. Më poshtë, shkëmbi i mantelit pjesërisht i shkrirë, përhapet në drejtime të kundërta, duke e shtrirë koren e re derisa të formojë një sistem të gjerë luginash të rrethuara nga kreshta kodrash dhe malesh. Këto peizazhe detare në thellësitë e mëdha, jo shumë ndryshe nga peizazhet që shihen mbi nivelin e detit, janë vendet e fundit ku pritët të shfaqen pjesë të kontinenteve. Megjithatë, në një studim të fundit të botuar në "Science Advances", studiuesit kanë zbuluar se kjo është vërtetë e mundur.

Shkëmbinjtë e sapo-analizuar nga Kreshtën Indiane Jugperëndimore, e vendosur midis Afrikës dhe Antarktidës,

nuk janë vetëm mbetje të një kontinenti. Ato janë aq të vjetra sa të mbështesin hipotezën se shumica e kontinenteve të Tokës u formuan herët, dhe më pas "humbën" ose u fshehën thellë nën koren e oqeanit. Çuan-Zhu Liu, gjeolog detar në Akademinë Kineze të Shkencave në Pekin, vizitoi në vitin 2017 Institutin Oqeanografik "Eoods Hole" në SHBA për të mbledhur mostrat e shkëmbinjtë të gjermuar nga kreshta pak kohë më parë. "Unë nuk do të kisha dyshuar se shkëmbinjtë u përkasin kontinenteve, pasi ato duken si materialet që zakonisht do t'i gjeje në fundin e detit"-thotë ai. Analiza e Liu tregoi se shkëmbinjtë janë ndoshta deri në 2.7 miliardë vjet të vjetër. Pra do të kenë ekzistuar me siguri kur u formuan kontinentet e

para të Tokës. Megjithatë, është e vështirë të zbulosh se nga cili kontinent antik e kanë origjinën.

Liu thotë se rrymat e konveksionit në mantelin e Tokës, mund të transportojnë në distanca të mëdha blloqe të mëdha të kores së tokës, të quajtura kraton. Një kraton i veçantë tërhoqi vëmendjen e studiuesit. "Ka prova se është zhvendosur kratoni Kapval në Afrikën e Jugut" – thotë ai. Kratoni Kapval është korja e lashtë kontinentale më e afërt me Kreshtën Indiane Jugperëndimore. Për të arritur në kreshtë, Liu dhe kolegët e tij mendojnë se shtëllungat e shkëmbinjtë të mantelit të nxehtë nën Afrikën e Jugut, e gërryenin fundin e kratonit, duke hequr pjesë që më pas u transportuan nga rrymat e


konveksionit deri në kreshtën e oqeanit.

"Nën kontinentin afrikan ka shumë shtëllunga të tilla, pasi atje ndodhej qendra e super-kontinentit Pangea që ngrohte mantelin"- thotë bashkë-autori i studimit Ros Miçell, gjeofizikannë të njëjtën akademi si Liu. Studiuesit kryen simulime kompjuterike, dhe zbuluan se deri në 20 për qind e kratonit Kapval, mund të ishte zhvendosur në këtë mënyrë, dhe të jetë ricikluar në tëçarën e oqeanit çdo 100 milionë vjet. Ky zbulim, na ofron edhe një pasqyrë të evolucionit të kontinenteve të tjera të Tokës. Tradicionalisht, për shkak se në sipërfaqe ka pak shkëmbinj shumë të vjetër, kontinentet mendohet se janë zgjeruar gradualisht. Por tani ka një shpjegim tjetër: Ndoshta shumë

nga kontinentet u formuan herët, dhe u ricikluan sërish në mantel.

"Nëse Toka kishte dikur kontinente voluminoze, me siguri këto 'kontinente të humbura' janë të fshehura poshtë kores"- thekson Miçell. Riciklimi i kontinenteve të humbur nën thellësitë e oqeanit, mund të ketë qenë i mundur falë shtëllungave që ishin edhe më të nxehta gjatë historisë së hershme të Tokës, shton ai.

"Nëse ndodh sot, atëherë do të ketë ndodhur vërtet edhe në atë kohë. Nëse këta shkëmbinj janë pjesë e kontinenteve të humbura, simulimet kompjuterike të studiuesve sugjerojnë se mund të ketë më shumë të tillë në kreshtat në mesin e oqeanit"- përfundon Miçell. / Discover Magazine – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Erjon Kastrati, ambasador i FBK-së në programin FIBA SWISH +

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Basketbollisti i KB Golden Eagle Ylli dhe i Përfaqësueses së Kosovës, Erjon Kastrati, do të jetë ambasador i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në programin FIBA SWISH +. SWISH + është Program i Edukimit për Integritet të FIBA Europe dhe realizohet në partneritet me Sportradar. SWISH+ është një program i krijuar qëllimisht me synim edukimin e pjesëmarrësve të përzgjedhur mbi temat kryesore të integritetit në basketboll dhe edukimin për integritet në përgjithësi. Gjatë dy ditëve të qëndrimit në Munich më 20 e 21 qershor, pjesëmarrësit do të trajnohen nga specialistë të integritetit të sportit dhe

edukimit për t'i pajisur ata me aftësitë, njohuritë dhe besimin në mënyrë që kur të kthehen në vendet e tyre, këta ambasadorë t'i edukojnë brezat e rinj për integritet në sport. Misioni i programit SWISH+ është të qëndrojë brenda kufirit të integritetit dhe të krijojë një mënyrë të shkallëzuar për të ofruar edukim për integritetin për një gamë të gjerë audiencash. Pjesëmarrësit e SWISH+ janë lojtarë (aktualë ose të mëparshëm), persona të përshtatshëm që janë emëruar nga federatat e tyre kombëtare në bazë të profilit të integritetit të tyre. Programi do të përfshijë dy punëtori të plota në person. Ligjëruesit me cilësi të larta kanë



planifikuar, krijuar dhe do të ofrojnë një program angazhues dhe interaktiv të të mësuarit. Në ditën e parë,

pjesëmarrësit do të mësojnë se çfarë do të thotë integriteti sportiv dhe çështjet kryesore që dalin nga integriteti. Në ditën dytë pjesëmarrësit do të trajnohen mbi teknikat dhe strategjitë që duhen përdorur gjatë edukimit nga ana e tyre për brezat e rinj në vendet e tyre. Në fund të programit pjesëmarrësit do të bëjnë një vlerësim të shkurtër për ta vërtetuar mësimin dhe vullnetin e tyre dhe do të pajisen me një certifikatë të përfundimit me sukses të programit. Pas përfundimit të programit, pjesëmarrësit do t'u jepet përmbajtja arsimore që ata pritet më pas ta ndajnë këtë njohuri me basketbollistët/et e reja në vendet e tyre.

Kosova U15 shënon fitoren e parë në Turqi



Prishtinë, 20 qershor - Në Edirne të Turqisë është duke u zhvilluar turneu i FIBA Europe Youth Development Fund për grupmoshat U15 (djem/vajza), në të cilin janë duke marrë pjesë pesë shtete si: Turqia, Kosova, Rumania, Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut. Vashat "dardane" janë mundur nga Rumania me rezultat 53:42. Fitore Kosova ka realizuar në ndeshjen ndaj Rumanisë në konkurrencën e meshkujve,

ku "dardanët" e rinj kanë triumfuar ndaj Rumanisë me rezultat 65:56. Humbje kanë pësuar vashat dhe djemtë e rinj në dy ndeshjet e para të zhvilluara në fundjavën që lamë pas. Djemtë kanë përjetuar humbje nga Bullgaria me rezultat 67:71, kurse vajzat e humbën ndeshjen nga Bullgaria me rezultat 84:43. Humbje kanë regjistruar edhe nga Turqia, ku djemtë janë mundur me rezultat

101:40, kurse vajzat kanë pësuar disfatë me shifrat 71:44. Ndeshjet e fundit Kosova i zhvillon të martën ndaj Maqedonisë së Veriut, ku vajzat e fillojnë ndeshjen nga ora 12:00, derisa djemtë nga ora 14:00. Njëherësh ky është turneu i fundit i këtij cikli të FIBA Europe Youth Development Fund, në të cilin projekt së bashku janë Turqia, Kosova, Rumania, Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut.

Sadiku kërkohet nga Sporting Gijoni

GIJON, 20 QERSHOR - Armando Sadiku shënoi gjashtë gola me Las Palmas në sezonin e fundit, ekip me të cilin luajti në duelet "play-off" për t'u ngjitur në La Liga. Objektivi nuk u arrit, ndërkohë që sulmuesi nga Elbasani del lojtar i lirë më 1 korrik. 31-vjeçari filloi të shënonte dhe arriti një formë të mirë në fundin e sezonit, drejtuesit e Las Palmas i ofruan

rinovimin, por deri tani nuk ka asnjë akord. Gjithsesi, lojtari i kombëtares shqiptare mund të vijojë të qëndrojë në La Liga 2. "Onda Cero" shkruan se për Sadikun ka interesim nga Sporting Gijoni. Emri i lojtarit shqiptar ndodhet në krye të listës së dëshirave të Javi Ricos, drejtorit sportiv të klubit asturian. Gijon ka ambicie të rikthehet në



elitën e futbollit spanjoll. Sezoni i fundit ishte për t'u harruar, djemtë e Abelardos u renditën në vend të 17, ndërsa drejtuesit po punojnë për ta përforcuar skuadrën. Nëse gjendet gjuha e përbashkët, Sadiku do të luajë prej sezonit të ardhshëm në "El Molinon", stadiumin më të vjetër në Spanjë në përdorim që nga viti 1908.

Roma përfundimisht heq dorë nga Xhaka

ROMË, 20 QERSHOR - AS Roma raportohet se ka hequr dorë nga transferimi i Granit Xhakës. Futbollisti nga Kosova që nga viti i kaluar është i lidhur me një kalim në "Olimpico", por një lëvizje të

tillë duket se po shkon drejt dështimit. Sipas "Il Tempo", bisedimet janë ndaluar pasi Roma nuk është pajtuar me çmimin e kërkuar nga Arsenalit për shitjen e Xhakës. "Topçinjtë" thuhet se po

refuzojnë ta shesin reprezentuesin e Zvicrës për shumë nën 20 milionë euro dhe një numër i klubeve të tjera tashmë po ndjekin nga afër zhvillimet. 29-vjeçari ishte sërish i rregullt në formacionin

e Arsenalit në sezonin e fundit, por ai nuk mendohet të jetë në planet e trajnerit Mikel Arteta për të ardhmen. Granit Xhaka me londinezët ka kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2024.



Hamiltoni, pas garës së Kanadasë: Ky sezon mund të ndryshojë tërësisht në vijim

OTTAWA, 20 QERSHOR - Nga ferri i garës së Baku, ku u rendit i katërti mes shumë dhimbjesh dhe vendit të tretë në Montreal, duket sikur ka kaluar një jetë, por në fakt janë vetëm shtatë ditë. Podiumi i arritur të dielën në mbrëmje në pistën kanadeze ka

rikthyer buzëqeshjen te Lewis Hamiltoni. "Dua ta falënderoj të gjithë stafin tim, që punojnë çdo fundjavë fort, këtu në pistë e fabrikë. Është e vështirë të punosh kur nuk sheh përparim dhe deri më tani ka qenë një sezon i vështirë për mua në

nivelin personal. Ky vend i tretë në Kanada ishte i rëndësishëm për ne", ka thënë Hamiltoni. "Gjatë kësaj kohe jemi impenjuar shumë dhe vendi i tretë në Kanada më ka dhënë më shumë besim, sidomos në faktin që mund të përmirësohem

edhe më tej. Kjo makinë ka potencial edhe pse nuk është 100 % ajo që dëshirojmë. Kemi një dritare të vogël ku punojmë, ndaj kam besim se ky sezon mund të ndryshojë tërësisht në vijim", ka shtuar shtatë herë kampioni i botës.



Përquku dhe Tuhina, optimiste për Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Përfaqësuesja A e femrave është në fazën e përgatitjeve për ndeshjet në kuadër të FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla që do të mbahet në Qipro nga 28 qershori deri më 3 korrik. Rreth pritshmërive ka folur kapitenia e Përfaqësueses, Arbnore Përquku. "Vitën e kaluar kemi zënë vendin e tretë, kurse këtë vit presim që të dalim kampion përballë përfaqësueseve që marrin pjesë", ka thënë Përquku për faqen zyrtare të FBK-së.

Basketbollistja e njohur ka folur edhe për ndjenjën si kapitene: "Është viti i dytë rresht që jam kapitene. Është ndjenjë shumë e veçantë. Përveç që është ndjenjë shumë e mirë, është edhe përgjegjësi pasi që përfaqësojmë ngjyrat e shtetit në arenën ndërkombëtare". Edhe basketbollistja e talentuar Astera Tuhina ka shprehur optimizëm për garat në Qipro. "Shpresojmë që ta përfundojmë kampionatin si kampione. Nuk është shumë e



vështirë për ta arritur, por duhet shumë punë. Do ta japim maksimumin që të paraqitemi sa më mirë" ka thënë Tuhina për faqen e FBK-së. Tuhina ka folur edhe për atmosferën brenda Përfaqësueses: "Atmosfera është

shumë e mirë dhe shpresoj që të jetë kështu deri në fund sepse është shumë e rëndësishme për paraqitjen e Përfaqësueses në këtë kampionat". Kosova aventurën në Nicosia të Qipros e fillon më 28 qershor në ndeshjen me Maltën.

SHKURT

Rudigeri paraqitet te Reali

Mbrojtësi Antonio Rudiger është paraqitur sot te Real Madridi. Mbrojtësi gjerman kaloi testet mjekësore këtë të hënë dhe më pas ka nënshkruar zyrtarisht me "Los Blancos". Rudiger ka nënshkruar kontratë katërvjeçare në praninë e presidentit Florentino Perez. 29-vjeçari te Real Madridi do ta mbajë numrin 22 në fanellë. Ish-mbrojtësi i Chelseat në "Santiago Bernabeu" ka kaluar si lojtar i lirë pas skadimit të kontratës me "Blutë".

Roma e ka të pamundur transferimin e Ronaldos

Cristiano Ronaldo mund të largohet nga Manchester Unitedi. Si gjithnjë flitet për një kalim të mundshëm te Sporting Lisbona, por në medie doli dhe emri i Romës, për vetë faktin se verdhekuqtë kërkojnë në treg emra të rëndësishëm për ta rritur nivelin e cilësisë dhe përvojës. Pavarësisht prej zërave, sipas "Corriere dello Sport", Ronaldo te Roma është një ëndërr e ndaluar, për disa arsye. Roma nuk e ka luksin të shpenzojë për ta blerë kartonin e një lojtari 37-vjeçar. E dyta, paga e tij mbetet një problem edhe më i madh, aktualisht përfiton 23 milionë euro neto në sezon. Ronaldo kërkon minimumin një kontratë dyvjeçare, një tjetër pengesë serioze. Mes tij dhe Mourinhos nuk është një ka një marrëdhënie të shkëlqyer, të gjitha këto kanë bërë që opsioni për t'u transferuar te Roma të bie ende pa marrë formë të plotë.

Goetze arrin marrëveshje me Frankfurtin

Mario Goetze ka zgjedhur klubin e radhës në karrierë. Fantazisti gjerman, i cili mbahet mend për golin e shënuar ndaj Argentinës në finalen e Botërorit Brazil 2014, ka arritur marrëveshje me Eintracht Frankfurtin. "Sport 1" shkruan se fituesit e Ligës së Evropës e kanë bindur 30-vjeçarin të rikthehet pas dy vjetësh në Bundesliga, kampionat ku më parë ka luajtur me Borussia Dortmundin dhe Bayern Munchenin. Goetze ka edhe dy vjet kontratë me PSV-në. Klubi holandez kërkon 4 milionë euro për ta lënë të lirë lojtarin ofensiv, shumë që drejtuesit e Eintrachtit nuk e kanë problem ta paguajnë.

Liverpooli 'blindon' katër futbollistë

Nënkampioni i Evropës dhe Anglisë, Liverpool, po mendon për "blindimin" e lojtarëve të rëndësishëm. Sipas "The Mirror", drejtuesit anglezë janë gati t'i fillojnë bisedimet me katër futbollistë për rinovimin e kontratave. Për Joe Gomezin spekulohet se mund të largohet në afatin kalimtar të verës, por Liverpooli thuhet se do t'i ofrojë kontratë të re atij, me aktualen që skadon më 30 qershor 2024. "Të Kuqtë" thuhet se do të ulen dhe të bisedojnë edhe me Diogo Jotan për zgjatje të bashkëpunimit, pasi sulmuesi regjistroi një sezon të shkëlqyeshëm. Portugezi ka kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2025, por klubi dëshiron që ai të qëndrojë edhe më gjatë në "Anfield". Naby Keita, i cili ka kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2023, është gjithashtu në listën e futbollistëve që mund të mbetet më gjatë te Liverpooli, pasi klubi synon t'i fillojë bisedimet edhe me të. 19 herë kampionët e Anglisë planifikojnë që kontratë të re t'i ofrojnë edhe të riut Harvey Elliott, pasi ai vlerësohet si një futbollist më të ardhme të ndritur. Tani për tani 19-vjeçari ka kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2026.

Liverpooli 'blindon' katër futbollistë

Nënkampioni i Evropës dhe Anglisë, Liverpool, po mendon për "blindimin" e lojtarëve të rëndësishëm. Sipas "The Mirror", drejtuesit anglezë janë gati t'i fillojnë bisedimet me katër futbollistë për rinovimin e kontratave. Për Joe Gomezin spekulohet se mund të largohet në afatin kalimtar të verës, por Liverpooli thuhet se do t'i ofrojë kontratë të re atij, me aktualen që skadon më 30 qershor 2024. "Të Kuqtë" thuhet se do të ulen dhe të bisedojnë edhe me Diogo Jotan për zgjatje të bashkëpunimit, pasi sulmuesi regjistroi një sezon të shkëlqyeshëm. Portugezi ka kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2025, por klubi dëshiron që ai të qëndrojë edhe më gjatë në "Anfield". Naby Keita, i cili ka kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2023, është gjithashtu në listën e futbollistëve që mund të



mbetet më gjatë te Liverpooli, pasi klubi synon t'i fillojë bisedimet edhe me të. 19 herë kampionët e Anglisë planifikojnë që kontratë të re t'i ofrojnë edhe të

riut Harvey Elliott, pasi ai vlerësohet si një futbollist më të ardhme të ndritur. Tani për tani 19-vjeçari ka kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2026.

Tre futbollistë pritet të largohen nga Interi

Nga Interi pritet të largohen disa futbollistë në këtë afat kalimtar. Tre të parët pritet të jenë Sanchez,

Vidal dhe Correa. Sulmuesi Alexis Sanchez përfiton 7 milionë euro dhe kjo e rëndon arkën e klubit,

prandaj Interi është gati ta shesë për 4 milionë euro. Për ish-sulmuesin e Arsenalit interesim

kanë shfaqur River Plate dhe Galatasaray. Mesfushori Arturo Vidal pritet të jetë lojtar i ri i Boca

Juniorsit derisa për Joaquin Correa kanë shfaqur interesim Newcastle United dhe Marseille.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDESKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, bazuar në nenin 39 paragrafin 3 Ligji Nr. 06/L - 054 Për Gjykatat, neni 6 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor dhe Vendimit KGJK-së Nr. 252/2022 të datës 31 maj 2022, shpall:

KONKURS PUBLIK PËR ÇERTIFIKIMIN DHE EMËRIMIN E EKSPERTËVE

PARIMET E PËRGJITHSHME:

- Eksperti gjyqësor ushtron detyrat e tij në pajtim me rregullat dhe parimet e përgjithshme, përfshirë parimin e ligjshmërisë, pavarësisë, paanshmërisë, konfidencialitetit dhe profesionalizimit;
- Eksperti gjyqësor zbaton udhëzimet sipas standardeve aktuale të shkencës, teknologjisë, përvijës dhe kujdesit të duhur;
- Përgatitja e mendimit dhe konstatimit të ekspertit duhet të jetë objektive dhe e paanshme. Gjatë përpilimit të ekspertizës, eksperti duhet t'i shmangët paragjykimet si dhe pranimit të përfitimëve tjera, përveç shpërblimit të përcaktuar me këtë rregullore;
- Eksperti duhet të deklarojë në fillim të procedurave gjyqësore se nuk ka ndonjë konflikt të mundshëm të interesit. Në rast se paraqitet konflikti i mundshëm i interesit ai/ajo duhet menjëherë të njoftojë të gjitha palët e interesuara dhe mund të tërhiqet nga caktimi i tij në rastin përkatës.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ÇERTIFIKIMIN E EKSPERTËVE GJYQËSOR

- Per t'u certifikuar si ekspert gjyqësor, kandidati duhet t'i plotësojë kushtet e përgjithshme si në vijim:
 - të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - të ketë zotësi të plotë të veprimit;
 - diplomë universitare të vlefshme në Kosovë në fushën përkatëse;
 - të mos jetë i dënuar për veprë penale, në përjashtim të veprës penale të kryer nga pakujdesia;
 - të ketë së paku tri (3) vite përvijë pune profesionale në fushën specifike apo të ngjashme; si dhe
 - të mos i jetë shqiptuar sanksioni ndalim i kryerjes së profesionit, detyrës apo veprimtarisë me vendim të plotfuqishëm të gjykatës;
- Përveç kushteve të përgjithshme, kandidati për t'u certifikuar ekspert gjyqësor duhet ta dëshmojë kompetencën dhe ekspertizën profesionale të tij/te saj me anë të kushteve specifike dhe mbështetëse, si në vijim:
 - Kualifikime profesionale që i ka arritur kandidati dhe që janë relevante për fushën e ekspertizës;
 - Trajnime dhe kurse të vecanta në të cilat kandidati ka marrë pjesë dhe që janë relevante për fushën përkatëse të ekspertizës;
 - Çmime, botime ose përvija mësimore relevante për fushën e ekspertizës; dhe
 - Përvijë dhe aftësi profesionale të kandidatit, relevante për fushën e ekspertizës.
- Përjashtimisht nga dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, si ekspert gjyqësor mund të angazhohet edhe personi i cili ka njohuri në fushat specifike për të cilat mungojnë ekspertët të diplomuar nga universitetet përkatëse.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM

- Kandidatët në pajtim me nenin 8 Rregulloren nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor, duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim:
 - Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara;
 - Çertifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
 - Diplomë universitare përkatëse të vlefshme në Republikën e Kosovës;
 - Dëshminë mbi përvijën e punës përkatëse, të përcaktuar me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi;
 - Çertifikata shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike të kandidatit;
 - Çertifikatën nga evidenca penale, e lëshuar nga gjykata; dhe
 - Dokumentet tjera/dëshmitë e përcaktuara si në nenin 7 paragrafi 2 kësaj Rregullore.

MËNYRA E APLIKIMIT

- Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Këshill në formë fizike, përmes postës së rregullt ose postës elektronike, i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit;
- Për secilin kandidat krijohet dosje e cila përmban të gjitha dokumentet e prezantuar nga kandidati. Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve të Kandidatit për Ekspert Gjyqësor është përgjegjës për formimin, mbajtjen e dosjes dhe siguron kompletimin dhe përditësimin e saj deri në momentin e përmbylljes përfundimtare të procesit të emërimit;
- Kandidati në aplikacion cakton fushën e tij të ekspertizës për të cilën kërkon të certifikohet;
- Kandidati i cili aplikon për t'u certifikuar si ekspert gjyqësor në fushën e caktuar duhet të paguajë taksën prej **pesëdhjetë (50) euro**. Dëshmia për pagesën dorëzohet në momentin e aplikimit dhe nuk është e rimbursueshme.

FORMULARI I APLIKIMIT

- formulari mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e KGJK-së. (www.gjyqesori-rks.org);

- [Shkarko aplikacionin](#);

MËNYRA E APLIKIMIT

Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor në Zyrën e pranimit dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

Kandidati i cili aplikon për t'u certifikuar si ekspert gjyqësor në fushën e caktuar duhet të paguajë taksën prej pesëdhjetë euro (50 €). Fletëpagesa merret në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht në Departamentin për Buxhet dhe Financa. Dëshmia për pagesën dorëzohet në momentin e aplikimit dhe nuk është e rimbursueshme.

AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Afati për dorëzimin e aplikacionit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit, gjegjësisht deri me datën **05 korrik 2022**.

- Sekretariati i KGJK-së, Rruga "Luan Haradinaj" nr. 133, Prishtinë, në Zyrën e Pranimit.**
- 10000 Republika e Kosovës**

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Kimete Hasani B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit N.T.P "Lindi-Impex" me numër Unik identifikues: 810439225.

► Luljeta Selimi shpalle te pavlefshme dëftesën e vitit I,II,III te SHMLM "Dr. Xheladin Deda".

► Fehmi Skendri shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".

► Qendrim Sadiku shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".

► Misin Muslija shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Elena Gjika".

► Gentrit Kurti shpalle te pavlefshme Dëftesën e Klasës 12- te SHMLE "Hasan Prishtina".

► Qefserë Sahatqiu shpalle te pavlefshme dëftesën e vitit te 4-te dhe diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".

► "N.SH.T. Albakos" SH.PK. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me fletë përcjellëse nr. 810484361.

► Nuredin Kleqka shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së nëntë të shkollës "Rifat Berisha" Malishevë Berishë.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Sudski savet Kosova, na osnovu člana 39 stav 3 Zakona br. 06 / L - 054 O sudovima, člana 6. stav 1. i 2. Pravilnika br. 03/2022 o proceduri za licenciranje, imenovanje, uslove, prava i obaveze i naknade sudskih veštaka i Odluke SSK-a br. 252/2022 od 31. maja 2022. godine, objavljuje:

KONKURS ZA LICENCIRANJE I IMENOVANJE VEŠTAKA

OPŠTA NAČELA:

1. Sudski veštak vrši svoju dužnost u skladu da pravilima i opštim načelima, uključujući i načelo zakonitosti, nezavisnosti, poverljivosti i profesionalizma;
2. Sudski veštak primenjuje uputstva na osnovu aktuelnih naučnih standarda, iskustva i neophodne pažnje;
3. Izrada stručnog mišljenja i zaključka mora biti objektivna i nepristrasna. Prilikom sastavljanja veštačenja, veštak treba da izbegava predrasude, kao i prihvatanje drugih pogodnosti, osim naknade definisane ovim pravilnikom.
4. Veštak mora na početku sudskog postupka da izjavi da ne postoji potencijalni sukob interesa. U slučaju potencijalnog sukoba interesa on/ona mora odmah obavestiti sve zainteresovane strane i može povući svoje imenovanje u relevantnom slučaju.

OPŠTI USLOVI ZA LICENCIRANJE SUDSKIH VEŠTAKA

1. Da bi stekao zvanje sudskog veštaka, kandidat mora da ispunjava sledeće opšte uslove::
 - 1.1. da bude državljanin Republike Kosova;
 - 1.2. da ima punu poslovnu sposobnost;
 - 1.3. važeću univerzitetsku diplomu na Kosovu u relevantnoj oblasti;
 - 1.4. da ne bude osuđivan za krivično delo, osim za krivično delo učinjeno iz nehata;
 - 1.5. da ima najmanje tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u određenoj ili sličnoj oblasti; kao i
 - 1.6. da mu pravnosnažnom sudskom odlukom nije izrečena zabrana obavljanja profesije, dužnosti ili delatnosti;
2. Pored opštih uslova, kandidat za sudskog veštaka mora da dokaže svoje veštine i stručnost kroz specifične i prateće uslove, i to:
 - 2.1. Stručne kvalifikacije koje je kandidat stekao, a koje su relevantne za oblast veštačenja;
 - 2.2. Posebne obuke i kurseve na kojima je kandidat učestvovao i koji su relevantni za odgovarajuću oblast veštačenja;
 - 2.3. Nagrade, publikacije ili nastavno iskustvo relevantno za oblast veštačenja;
 - 2.4. Iskustvo i stručne sposobnosti kandidata relevantne za oblast veštačenja;
3. Izuzetno od stava 1. i 2. ovog člana, kao sudski veštak može se angažovati i lice koje ima znanja iz određenih oblasti u kojima nedostaju veštaci sa završenim odgovarajućim univerzitetima.

POTREBNI DOKUMENTI ZA APLICIRANJE

1. Kandidati u skladu sa članom 8. Pravilnika br. 03/2022 o postupku za licenciranje, imenovanje, uslove, prava, obaveze i naknade sudskih veštaka, mora dostaviti sledeća dokumenta:
 - 1.1. Aplikacija popunjena sa potrebnim podacima;
 - 1.2. Uverenje o državljanstvu Republike Kosova;
 - 1.3. Univerzitetsku važeću diplomu u Republici Kosova;
 - 1.4. Dokaz o relevantnom radnom iskustvu, utvrđenom ovim pravilnikom i zakonodavstvom na s snazi;
 - 1.5. Zdravstveno uverenje o psihofizičkom stanju kandidata;

1.6. Potvrda iz kaznene evidencije, izdate iz suda; i

1.7. Druga dokumenta /dokazi utvrđeni kao u članu 7. Stav 2. ovog Pravilnika.

NAČIN APLICIRANJA

1. Aplikacija se zajedno sa pratećom dokumentacijom može dostaviti Savetu u štampanom obliku, putem pošte ili e-mail-a, koja se registruje i svakom kandidatu se dostavlja potvrda o prijemu aplikacije;
2. Za svakog kandidata se kreira fajl koji sadrži svu dokumentaciju koju je kandidat podneo. Komisija za ocenjivanje aplikacija kandidata za sudskog veštaka odgovorna je za formiranje, održavanje, dosijea, i stara se o njegovom popunjavanju i ažuriranju do trenutka konačnog konačnog završetka procesa imenovanja;
3. Kandidat u aplikaciji određuje njegovu oblast veštačenja za koju želi da se licencira;
4. Kandidat koji se prijavi za dobijanje licence sudskog veštaka u određenoj oblasti mora da plati taksu od **pedeset (50) evra**. Dokaz o uplati se dostavlja u trenutku prijave i ne naknađuje se.

OBRAZAC ZA APLICIRANJE

- Obrazac se može preuzeti sa zvanične stranice SSK-a. (www.gjvqesorirks.org);
- **Preuzmi aplikaciju:**

NAČIN APLICIRANJA

Aplikacija se zajedno sa pratećom dokumentacijom može se dostaviti Sekretarijatu Sudskog saveta u Kancelariji za prijem i svakom kandidatu se dostavlja potvrda o prijemu prijave.

Kandidat koji konkuriše za dobijanje licence za sudskog veštaka u datoj oblasti mora da plati taksu od pedeset evra (50 €). Uplatnica se uzima u Sudskom savetu Kosova, odnosno u Odeljenju za budžet i finansije. Dokaz o uplati se dostavlja u trenutku prijave i ne naknađuje se.

ROK ZA PREDAJU APLIKACIJA

Rok za podnošenje aplikacije je petnaest (15) dana od dana objavljivanja konkursa, odnosno do dana **05. jula 2022.**

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Ordinanca Logopedike Logopedia M” SH.P.K. Pronar Meriton Bahtiri Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 811356022 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Ordinanca Logopedike Logopedia M” D.O.O. Meriton Bahtiri Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811356022 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Ordinanca Logopedike Logopedia M” L.L.C. Meriton Bahtiri Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 811356022 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mishi pule



cilësi e garantuar

pa konservues